

XHAFER

MARTINI

KUR  
BIE  
SHI

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH-1

M 36



VJERSHA  
E POEMÀ



XHAFER MARTINI,  
lindi më 1941 në Fushë-  
-Alië të Dibrës. Ka kryer  
Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë:  
Punon si korespondent  
i Agjensisë Telegrafike  
Shqiptare për rrethet  
Dibër dhe Mat. Ka filluar të botojë poezi në  
vitin 1960. Më 1968 doli  
me librin e parë «Tinguj  
rinorë». Kohët e fundit  
është marrë dhe me kritikë letrare.

8JH-1  
N°136

XHAFER MARTINI

# KUR BIJE SHI

vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

X  
nd  
Ali  
r  
isë  
Pun  
A  
Shq  
Dib  
llua  
viti  
me  
rinc  
ësh  
tikë

Piktore: SVETLLANA STRAZIMIRI

Tirazhi 2000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973

## P R A N V E R Ë

Jam ulur te trangu i qershisë së re.  
Diçka lëvrin në tërë qënjen time;  
jam bërë transparent dhe çuditërisht i ndjeshëm.

Dritat edhe ngjyrat, tingujt edhe zërat,  
gjithë shkrimin e jetës, gjithë dashuritë  
ashtu të koncentruara,  
i kam mu në zemër.



## F S H A T A R Ë T

Gjithshka ne e lidhëm me këtë tokë  
me dhembshurinë, me dashurinë e saj;  
për të ne shpesh kemi qeshur me zemër,  
për të ne shpesh jemi shkrehur në vaj.

Kur toka është me vlagë, kur toka është e butë,  
ne shkelim mbi të dhe ia marrim një kënge;  
e dimë se nesër ajo do të prodhojë,  
e dimë se nesër do të bëhet nënë.

Marrim në duar një grusht dhe  
dhe e shtrëngojmë me dashuri.  
Në duart tona dheu bëhet bukë,  
në duart tona dheu bëhet flori.

## VIOLINA

Edhe pas vdekjes së Qemalit  
violina e tij nuk pushoi së rëni,  
në vend të duarve të Qemalit  
tani i binte harku i erërave të shqetsuara.

Tri ditë e tri net (sipas zakonit të lashtë)  
violina qau për Qemalin.  
Tingujt e saj qenë të trishtuar  
tri ditë e tri net  
telat e saj qenë të ngarkuara me dhimbje,  
tri ditë e tri netë.  
(Ish pikëllimi i popullit që rridhte nëpër tela)

Pastaj fryri mbi tela tufani i urrejtjes popullore  
dhe filloi të vërshëllejë nëpër ta kushtrimi i  
luftës.

## RRËZË PARCELËS ME GRURË

Kaloj rrëzë parcelës me grurë  
dhe shoh si përkulen kallinjtë.  
Më përkund me një ëndërr të bukur  
ky det i madh, i flarinjtë.

Qysh dhjetë vjeç këmbët i vrava  
kur me plug hapja ugarë;  
tokën e bëra të butë, të shkruftë  
dhe hodha farë.

Ja... bimëzat panë diellin  
e tundin kryet plot gjelbërime.  
Më duket sikur rrënjët i kanë  
thellë në zemrën time.



## KUR BIE SHI...

Për shiun që bie njerëzit mendojnë në mënyra të  
ndryshme:  
Dikush mendon se duhet të kish mbathë galloshet,  
dikush kujtohet për çadrën që s'e mori,  
tjetri thotë thjesht: « U prish koha!»

Kurse mua mendja më vete tek toka:

Në se bimët lagin buzët e zhuritura,  
në se mugullon bari i ri,  
zemra ime thotë

«bjer, o shi!»

## LULET E ËNDRRAVE

Natyrisht e dua shumë  
vajzën time, Riketën!  
(Siç u ndodhi prindëve me mua)  
Tek ajo unë shoh veten.

Sa shumë vitet nxituan  
tani u bëra burrë  
po lulet e ëndërave  
nuk vyshken kurrë.

Ngre, ho-pa, Riketën  
dhe e tund në duar  
...Kap kështu balonat  
që më patën munguar.

Kap fëmininë time  
që iku me nxitim  
po gjaku në rremba  
lëviz, lëviz...

Dhe nga fëmijë  
bëhemi ne pleq.  
Diçka përherë shkon,  
përherë diçka vjen...



## V J E S H T A

Vjeshta erdhi e butë, e mëndafshtë  
mes trishtimit të verës që iku  
të spikat ndryshimet e natyrës në vjeshtë,  
qëndroj mu në fushë si polic trafiku.

Qëndroj i vetmuar dhe lagem nën shi.  
Era i bie me potere dajres  
dhe më vijnë në mend fjalët e saj me aksent të  
çuditshëm,  
si fjalë të shqetësuara në çastin e ndarjes.

Kjo era sot, mblesë e zonja,  
do t'më mbushë mendjen se vjeshta është e  
bukur.

(Kot lodhesh, erë, me këto që më thua,  
Unë të besoj edhe pa m'u lutur.)



Zhvishu, korie, nga ngjyra e gjelbërt  
(ndon'se për këtë ngjyrë dhe shpirtin e jap),  
zbrit ti. xheloz, mbi fusha e pyje  
që shpirtin meskin të ta fut në varg.

Rridh ti, pjellori, siç rrjedhin lumenjtë  
(se puna e drithërave na shqetëson).  
Vjeshtë, na i bën (si veten) të shëndetshme  
se vargu s'është varg, kur s'rëndon. vargjet,

## MBLEDHJE E PUNËTORËVE

Ata mbledhjet i bëjnë në frontin e punës  
(ndaj me zë të lartë flasin),  
ata nuk i bien temës rreth e rrotull,  
po me «predhën» e parë në shenjë godasin;

nuk zotërojnë shumë oratorira  
dhe nuk përdorin shumë citate,  
ata thonë thjesht: «Kështu thotë Partia!»  
Godet fjala e tyre si teh shpate.

Gjyqi i tyre është i drejtë. po i rreptë.  
Ec. po deshe e me frazeologji mbrohu;  
por, po u hape zemrën: «Gabove, shokë!»,  
ata nuk të thonë: «Thellohu», «Thellohu!»

Ata s'përkëdhelin, s'bëjnë elozhe  
askush s'të kërcënon, askush s'të lutet,  
po ti e ndjen se të kthyen në rrugë,  
se fjala e zemrës në zemër futet.



## PENDESA E MOISI GOLEMIT

Ai ish mburrja dhe nderi i Atdheut  
ai u priste kokat turqve si gjarpërinjve.  
Tani, i shtypur nga mendimet e zymta,  
ecën kokëulur nën hijet e ullinjve.

Kështu po endet, pa miq, pa shokë  
po e zbardh brenda një nate kjo vetmi  
dega e ullirit i përkulet mbi kokë:  
«Ç'bëre Moisi! Ç'bëre Moisi!»

Dhe hodhi sytë që i lëshonin shkëndia  
malet arbërore për të parë  
«Atdhe!» i klithi me fuqi zemra  
pranomë, jo gjeneral, por ushtar!»



## NXËNËSIT E SHKOLLËS SË NATËS

Si rreze dielli n'k'të ditë janari  
Erdhët ju dhe u ulët këtu, në bangë  
Me duart tërë kallo tani kapni pendën  
Në vend të shatit, që sapo keni lënë.

Kemi hartim... orë e bukur patjetër  
Të hedhësh në letër çka të vlon në gji.  
Dhe ja vjershat dalin... si misri i gjelbër,  
Si kallinjtë e grurit kokërr — flori.

Mjelësja Drane po shkruan në vargje  
Bashkë me zemrën i dridhet dhe dora,  
Vargjet e ngrohta si buzëqeshja e saj  
Derdhën në letër — si qumështi në kova

Ec me fletoret e tyre nën sqetull  
Endërat e tyre më rëndojnë mbi supe  
Se ato kanë plisa nga toka mëmë  
Bien erë djerse dhe erë buke

## XHA SHEMO

Xha Shemo, agait të fshalit  
I doli para me sopatë:  
«Më mirë unë lë kokën aga,  
Po grurin nuk e jap!»

U drodh nga zemërimi agai,  
U drodh e nxori alltinë.  
Shtatë plumba nga gryk' e zjarhtë  
Xha Shemos gjoksin ia grinë.

Dhe ra, xha Shemo, ngadalë  
Mbi tokë, si kalli i prerë.  
Aty, mbi duajt e grurit  
Mbështeti kokën të flerë.

Si një grusht i vetëm fshatarët  
Rendën kundër agait mizor  
Gjaku i xha Shemos, u bë at' ditë  
Flamur për çlirimin shoqëror.

## S O N T E

Sonte korridoret e konvikteve kanë një zhurmim  
të gëzueshëm.

Rendje nga një godinë në tjetrën,  
nga një kat — në tjetrin  
nga një dhomë — në tjetrën.  
Biseda të shkurtëra.

Sonte s'kemi kohë të dëgjojmë radio-postën.  
Të gjitha prizat e kateve janë zënë:  
Hekurosime shallet e aksioneve,  
pregatitimi valixhet, çantat.  
Sonte dritaret e të gjitha godinave  
ndriçojnë si sy të zjarrtë.





## KUR LEXON LIRIKAT E SEREMBES

Mbaron një lirikë dhe fillon një tjetër:  
të duket sikur je në një kopsht plot fruta e  
hije,  
pas çdo hapi ndjen sikur mbi supe  
janë duke të rënë lule qershie;

sikur del fushave e pyjeve me fletë,  
merr parmendën dhe ecën pas brazdave,  
ndjen gurgullimin e kronjve të fshatit  
dhe të qeshurat gazmore të vajzave.



## NUK KEMI PËRSE TË KTHEHEMI

Nuk kemi përse të kthehemi dhjetë vjet prapa,  
të shkojmë përsëri tek takimi i parë  
në bëmë kaq rrugë bashkë...

Në këtë rrugë, e dashur, qemë bujq të mirë  
rritëm, lule, pemë, fëmijë  
(pyesim për fëmijët se kujt i ngjajnë, mua apo ty?  
dhe biem në një mendje se na ngjajnë të dyve)  
Ja pra, dashuria jonë  
në transformim dhe rinovim të vazhdushëm.  
...Nuk kemi pse të kthehemi dhjetë vjet prapa...

## M I M O Z A T

Vdiq Xha Lipja papritur një mëngjez  
(Xha Lipja ishte roje në fakultet).  
Në varrim morën pjesë pedagogë e studentë.  
Në krye ecrim ne, tre studentë poetë.

Ishim të heshtur. Me sy të përbotur,  
me një dhembje të thellë e të përmbajtur,  
që të tre ne (në heshtje) vargje krijojmë  
për Xha Lipen e mirë, për Xha Lipen e dashur.

Po vjershat na dolën të rënda, të zymta.  
Pikonin lotët në strofa dhe vargje,  
kurse Xha Lipja e shkundte gëzimin,  
siç shkundin zogjtë borën nëpër pragje.

Ç'të bënim? Morëm nga një tufë mimozash  
(mimozat Xha Lipes i pëlqenin shumë)  
dhe, duke kujtuar buzëqeshjen e tij,  
mu sipër varrit, te koka ja vumë.



## NË SYTË E LIDËS

Në sytë e Lidës lundrojnë stinat  
me tërë begatinë dhe ngjyrat e tyre,  
shiko thellë në atë kaltërsi  
dhe do të tundet natyra përpara syve.

Në sytë e saj — ditët që shkuan,  
në sytë e saj — ditët që vinë.  
Si në një ekran të gjërë në sytë e Lidës  
çdo çast ndrohen katër stinë.



## D Ě B O R A

Dëbora e parë ka rënë mbi Tiranë  
aq pak, sa këmba s'lë dot gjurmë,  
po vajzat dhe djemtë e mbledhin me grushte...  
Unë që vij nga Korabi, çuditëm  
si mund ta duan dëborën kaq shumë.

Po fundja e kuptoj se ka diçka të dashur,  
ka diçka të bukur në këto flutura dëbore.  
dhe siç ndodh me mua:  
Më hynë shumë shpejt në zemër  
këto rrugë, këta njerëz dhe kjo pamje dimërore,

dhe sulem në sheshin «Skënderbej» si çunak  
15-vjeçar.

Majtas e djathtas këdo gjuaj me dëborë  
po goditja preçize e një gjimnazisteje  
bën që të kap ballin me dorë.

Po dhembja u harrua... ajo pamje dimërore  
si një lirikë e ngrohtë më futet në shpirt  
dhe sytë e vajzës së bukur gjimnaziste  
më ndoqën pas të qeshur shumë ditë.

## M A R I !

Braktise, Mari, burrin që të dhanë,  
burrin «e zgjedhur» me dy dipllova;  
tonat, Mari, janë gjithë shtigjet e atdheut,  
e sotmja dhe e ardhmja është jona.

Mari, Mari! S'po të bëj thirrje  
si një egoist që ka humbur diçka,  
po si një ushtar i revolucionit,  
si një shok i dashur, si një mik, si v'lla.

Do ta kuptosh në ç'mjergull jetoj  
nga fushata e tërbuar e prindërve të tu.  
që për diplomat e televizorin  
paturpësisht dikujt i bien në gju.

Braktise, Mari, se do të të marrë frymën  
dhoma  
edhe pse me perde tyli e orendi të rralla.  
ashtu siç t'u muar fryma në kafe «Flora»  
ditën e fejesës, kur u dha fjala.

Braktise, Mari, se unë të njoh mirë...  
Ti s'e duron shtirjen, jetën e kotë.  
S'është turp, Mari, që të rrëzohesh një herë,  
por është turp po të mos ngrihesh dot.



## MURRO

Gjithë jetën e kaloi mes arave,  
gjithë jetën zgjedhën mbajti mbi supe;  
nga kaloi Murrua u derdh djersa,  
nga kaloi ai, mbiu buka,

Babai im është bujk i mirë  
dhe kaun si perëndinë e adhuronte;  
Murros i jepte jonxhë të butë,  
Murros kashtë poshtë i shtronte.

Po u plak Murroja, u plak  
dhe një ditë midis hullisë u shtri.  
Babai lëshoi parmendën  
dhe Murron pa në sy.

Po sytë e Murros nuk shprehnin asgjë:  
ishin ngulur në hulli pa jetë.  
Ish hullia e fundit të tij:  
kafsha fisnike kish vdekë.

## SHQETËSIM

Rrotullohen e rrotullohen ditët  
çdo çast pohoj e mohoj në veten time  
përpiqem ta kaloj veten, ta mund atë  
shpesh ja dal mbanë, shpesh arrij në zgjidhje  
kompromisi.

Prap të nesërmen nis...  
Me ditën e re më lindin mendime të reja,  
përftyroj portretin e së ardhmes...  
Pranë zhurmës së kohës, shqetësimit të saj,  
antenave të radios, të televizorëve, sinjaleve  
elektronike  
Dhe të sa e sa shpikjeve që i di dhe s'i di,  
vë veten time.

Vë gjykimin tim mbi klithmat demagogjike,  
mbi bombardimet në Vietnam,  
mbi agresionin izraelit...



Vë gjykimin tim mbi vargjet e mia dhe të shokëve  
të mij,  
mbi teknikat artistike dhe mendimin solid.

Dhe papritur ... tërë pesha e shqetësimit pështetet  
mbi mua

kur bëj pyetjet:

Ç'bëj unë që të eci me kohën,

Ç'bëj unë për të arritur atë?



## PUSAXHIU

«Pusaxhi i rrallë,  
vdiqe apo s'vdiqe?»

Popullore

Xha Selim, punove  
një jetë të tërë  
në puset e thella  
në puset e gjëra.

Xha Selim, ti s'hape  
puse për «të ngratit»,<sup>1)</sup>  
ku të mbushnin ujë  
nuset e fshatit,

ku çdo udhëtar,  
bërë shkrumb nga vapa,  
ty të t'uronte  
ditë të gjata.

Porse për këtë  
s'të qortoj dot unë  
se ishe i varfër,  
kishe halle shumë.

Ndaj ti u robtove  
në jug e në veri  
duke hapur puse  
për zonja e zotëri.

...Dyzet ditë punove  
në të madhen derë,  
dyzet pashë pusin  
e çove thellë.

Edhe kur agai  
këtë mori vesh,  
i shkuan mornica,  
trupi iu rrëqeth.

Flokët iu ngritën  
si gjëmbe iriqi,  
dhëmbët e rrallë  
si bishë i skërmiti.

«S'dua pus të tillë  
dyzet pashë thellë.  
Nga kjo thellësi  
ujët kush e nxjerr?»

Bini leckamanit,  
qenit të zgjebosur!»  
uluriu agai  
tepër i xhindosur.

Të rrahnë, Xha Selim,  
me kërbag, me dru;  
lidhur me zinxhirë,  
ku të hodhën, ku?

Ah, në fund të pusit,  
dyzet pashë thellë,  
ty të mbyti ujët  
dhe nuk pe më diellë.

Të hodhën përsipër  
gurët që ti nxore.  
Jo, nuk ka në jetë  
vdekje më mizore!

Vdiqe, Xha Selim,  
mbushur helm e brengë.  
Populli që të deshi  
të ngriti një këngë.

Përplaset kjo kënga  
si vala në brigje:  
«Pusaxhi i rrallë,  
vdiqe apo s'vdiqe?»

---

\* të ngratit = të varfërit.



## D E T I

Është dimër.

Kam ardhur në bregdet.

Kabinat e plazheve kanë mbetur të heshtura,  
të heshtura kanë mbetur bar-bufetë, restorantet,  
veç era me shiun grinden mbi ta.

Po deti është aty

i madh e i fuqishëm.

Pyes veten: Pse e dua detin?

Dhe këtë pyetje e bëj kur nuk është ditë plazhi  
dhe shoh dallgët e detit që ngrihen si male,  
shoh detin... dhe s'mund që ta shoh.

Ai është pafundësi...

Ndoshta për këtë e dua detin.

## VOGLUSHJA VIETNAMEZE

Voglushja Le Fen me fjongo të gjelbër  
E qeshur po mblidhte lule në bregore  
Në qiell fluturuan shpendët e hekurt  
Duke hedhur bomba mbi orrizore.

Mbi dhé tani s'dukej veç një re ngjyrë plumbi  
Nga vdekje-prurësi — napalmi i egër  
Vdekja, që sollën jankitë kish ngrirë  
Edhe Le Fenin me fjongon e gjelbër.

Akoma duart e saja të vogla  
Shtrëngonin lulet e nxira, të thara  
Ato duar thonin në të gjitha gjuhët:  
«Kundër jankive! Përpara! Përpara!

## GJITHMONË PRANË

— Dëshmoret dibrane Rukie Roshi —

Rukije, sapo u ktheva nga zbori  
Në trup kam erën e kripur të djersës.  
Në armaturë pushkën s'e kam lënë,  
Uniformën e gjelbër s'e kam hequr.

Kështu, siç jam, po ndalem tek varri yt  
Si poet, si student dhe si ushtar,  
Me heshtjen time ty të të flas shumë  
Dhe një grusht me dhé nga ky varr ta marr.

Po të lë këtu një tufë me vjollca  
Me dashuri si shok armësh, si vëlla.  
Do të të ndjej gjithmonë pranë, Rukije  
N'auditore dhe n'marshimet e mëdha.

## TOKAT E REJA

Nuk e kemi të lehtë të ngjitemi tek ju,  
Të çajmë dëborën dhe të thyejmë akullin.  
Po do të na mallkonin brezat e ardhshëm  
Në qoftë se sot nuk do t'ju hapim.

Dhe na duki më të shtrenjta, më të mira  
Tani që mbi ju, si lumë, rrjedh djersa  
Po që se armiku do na djegë fushat  
Ju do na bëheni hambarë dhe fortesa.



## FLASIN GJURMËT

Dhe rrjedhin vitet, derdhen lumë  
Vrapojnë me revan,  
Po ja të fshehura në gjurmë  
Kujtime kjo tokë mban.

Kanë një histori më vete  
K'to brigje e gëmusha  
...Këtu pimë ujë atëhere...  
Këtu ka krisur pushka.

Këtu kaluam ne ilegalë  
Natën, nën tela, barkas  
Këtu një natë delegatët  
I vunë gjoksën flakës.

Këtu kaluam mes plumbave  
Shkumbinin turbulluar.  
Kish plot armiq kjo rrugë e gjatë  
Në Kongres<sup>1)</sup> për të shkuar.

...Kështu, me radhë flet çdo gjurmë  
Të gjitha ato thonë:  
«Liria na kushtoi shumë,  
Të mbrojmë lirinë tonë!»

---

1) Është fjala për Kongresin e parë të BRASH-it që u mbledh në Helmës.

## I N T I M E

Diç do t'më thuash, diç dua të të them,  
po gojën s'e hapim dhe ecim të heshtur.  
... Ja, buzë këtij lumi, një natë të tillë  
ti kokën mbi sup më ke mbështetur.

Dhe valët e blerta, që aq shumë na deshën,  
na hodhën në këmbët stërkala e shkumë.  
Ish hera e parë që ti kokën mbështetje  
te një burrë... pikërisht tek unë.

## PËR GJOKË DOÇIN

Për Gjokën tani kemi një bust,  
disa kujtime dhe një këngë popullore.  
Vijnë fëmijët më 5 maj te busti,  
vënë kurora me luleborë.

Vijnë nënat trime që nga Lura  
dhe i ulen pranë në mermerin e ftohtë,  
e fërkojnë me duar sikur t'ish i gjallë.  
duke thënë: «Na mori malli, Gjokë!»

Do t'i ulen gjithmonë pranë nënat  
«trimit që s'iu përkul shqotës».  
Pleqtë do thonë në dasma e gëzime:  
«Ia merrni një herë këngës së Gjokës!»



## GAZI I ZEMRAVE

Ndjej gëzim kur shoh vajzat dibrane  
Duke kërcyer në këtë sallë<sup>1)</sup>  
Perdja hapet... një dritë trëndafili  
Sikur po çel një agim i bardhë.

Valija merr zjarr, vetëtijnë xhupat  
Valltareve u gufon gjoksi, zemra  
Ndjej se po shembet kanuni i vjetër  
Me konturet e tija të zeza.

Shkundin gazin e shpirtit vajzat  
Dhe vjen ai e na hyn në zemra.  
Sjellin ato erën e vendlindjes,  
Fëshfëritjen e pyllit me gështenja.

---

1) salla e teatrit të Operas.

## SA BUKUR

Sa bukur kjo mbrëmje, Mirela  
me shushërimën e ëmbël të fletëve  
me rrjedhën e kaltër të dritës,  
me hënën që na shikon midis degëve.

Ç'sinfoni tingujsh nga ujvarat  
vështro, Mirela, për rreth, vështro!  
Nuk duhet të mbyllemi brenda  
në një natë të bukur si kjo.

## MIRË SE ARDHE

Sonte duke goditur me grushte  
m'i hape portat e kujtesës  
në fronin e ndjenjave e pushtetëshme m'u ule.  
Unë as që mundem dhe as që dua të të dëboj.  
Siç duket shumë të ka marrë malli  
ndryshe s'do të bëje një rrugë kaq të gjatë.

Dhe unë e ndjej se ti më ke munguar.  
Dhe unë e ndjej se ty të kam pritur.  
Mirë se ardhe!

## ME KOSTARËT

Pashë kostarët duke kositur bar:  
një vatër dëshirash m'u ndez, një vatër,  
m'u kujtua koha kur kositja në fshat  
dhe shkallët e konviktit zbrita nga katër.

Kisha dëshirë të kapja prapë kosën,  
«Kostari ynë» shokët të më thonë,  
të dëgjoja si binin nga kosa e mprehtë  
fijet e barit të njomë.

Po kostari plak s'e lëshoi kosën.  
«Këtë kosë — më tha — s'e përdor dot ti».  
Në çast m'u vrenjt balli  
si reja kur do të lëshojë shi.



U pendua shpejt kostari plak  
kur pa se m'u vrenjt balli.  
«Merre kosën, bir, merre — më tha —  
e kuptoj që qenke bir kostari».

E shtyrë nga fuqia e muskujve dhe e zemrës,  
kosa barin e njomë e shtrinte;  
breshëri e duartrokitjeve të shokëve  
nga gjithë katet e dritaret binte.

## A R I X H E S H K A

Arixheshkë, e bukura, arixheshkë,  
me ty mund të bija në dashuri!  
Pse vjen drejt meje me shporta?  
Unë shporta nuk dua nga ti.

As sita e shosha nuk dua,  
as fall nuk dua me shti  
mos më shih në pëllëmbë të dorës  
po shihmë drejt në sy.

Pse rri dhe pret thupra,  
pse rri në çadër breglumit,  
kur ëndërrat e tua janë të shumta,  
të shumta sa kokërrizat e kumit?

## LEGJENDË DIBRANE

E egër,  
e ftohtë  
ra nata;  
era nëpër pyje  
shkruan balada.

Bien yjet, bien  
tutje, përmbi Drin,  
hëna midis reve  
hesht edhe mërdhin.

Kjo heshtje e kobshme  
mbi atdhe rëndon,  
Gjergj trimi  
më nuk rron.



Qan çdo zemër, qan  
kjo tokë e halleve...  
gjaku shkon i mpiksur  
atje, midis valëve.

Qajnë malet, qajnë,  
qajnë burra, nëna,  
mbi çdo kështjellë  
ndriçon gjysmëhëna.

Mbi secilën zemër  
një mal dhembje ka,  
po prapë çdo zemër  
është një kala.

Trimat dibranë  
Me Pal Tuhani  
përpara Sinës  
e ndalën dushmanin.

Në not bie kali  
aty ku u derdh gjaku,  
nga lumi i kuq  
dridhet turkoshaku.



Malit të Xharxhishtit  
retë po largohen,  
po në kokë të Pashës  
retë shtohen, shtohen;

re të marrosura,  
re mendimesh  
brenda një nate  
prej tyre thinjesh;

dhe vijnë ato,  
vijnë dallgëshumë,  
ka net Pasha  
që rri pa gjumë.

Fjalët e Sulltanit  
si të gjallë e ropën:  
«Ja të marrësh Sinën,  
ja të preva kokën!»

Vendim Pasha  
merr menjëherë,  
niset për në Sinë  
tok me jeniçerë.

O tokë shqiptare  
dhunën si e mban?  
Patkonjtë shkëndija  
pluhur dhe duman...

Kurrë kështu ushtria  
nuk ishte parë —  
luftojnë dibranët  
burrat e gratë.

Bien turqit,  
bien radhë-radhë,  
qeshin malet  
qeleshebardhë.

Kthehet Pasha  
me çerek ushtrie,  
nuri i vdekjes  
në fytyrë i bie;

kthehet Pasha  
gjithë helm e vrer  
dhe gjëmon:  
«Tmerr!  
Oh, tmerr!

Bobo  
Nga Sulltani  
koka do më pritet!»  
Si qen i helmuar  
Pasha përpëlitet.

Del hëna, del  
dhe numron të vrarët,  
trimave dibranë  
u ndriçon armët.

Del hëna, del.  
mbi gjak noton,  
trimat dibranë  
ajo njatjeton.



### III

Sulltani i tërbuar  
ze e kërcet dhëmbët,  
përkulet Pasha  
dhe i puth këmbët.

Pashallarët e tjerë  
si gurë varri rrinë.  
«Falmë!

— lutet Pasha —  
paç Perëndinë!»

Sulltani nis vrejtjet  
si një mot i egër,  
Pashën e shënon  
me thikë në zemër.

Po qeni dinak  
prap' e ndërron fletën:  
«Çohu! — i bërtet —  
të kam falur jetën!»



Veç do t'rrjep të gjallë.  
po s'më prure, qen,  
treqind arnautka  
nuse në harem.

Tani hypi kalit  
për Sinë tufan!  
patkonjtë shkëndija,  
pluhuri duman.

#### IV

Fjalët e Sulltanit  
Çoi në Sinë Pasha.  
Pali shpejt i mvrejti  
vetullat e trasha.

Sytë' e zez të Palit  
shkrepëtinë egër,  
desh t'i ngulë turkut  
shpatën në zemër.

Po fjalën e mori  
ai më plaku,  
trimi i urtë,  
Nikë Ferraku.

«Për këtë «miqësi»  
Sulltanin njetjetojmë,  
treqind vashat  
do t'ja dërgojmë.

Nesër,  
me të aguar,  
le të na presë Pasha  
tridhjetë përcjellës  
me treqind vasha.

Veç na lejoni  
të punojmë arat,  
të korrin grunjat,  
që i kemi të mbara»,

Syt' e Nikut ndrijnë  
nga qeshje dinake,

si një vetëtimë  
në qiellin e një nate.

V

Nisën treqind «nuse»  
me tridhjetë krushq:  
shkëlqejnë zabeleve  
duvakët e kuq.

Eh, këto nuset,  
këto gjeraqina  
sa mirë u rrinë kuajve  
edhe në rrëpira.

Buzëqeshin turqit:  
— Bre, bre, treqind vasha! —  
Mjekrën nga gëzimi  
leht' fërkon Pasha.



Ç'dasmë do të bëhet,  
Eh, moj Dibra trime!  
Vargmalet bien  
thellë në mendime.

Dhembja i bren njerëzit,  
po turpi s'durohet,  
toka amtare  
sot po drithërohet.

Toka çeli gjinë,  
po rënkon ajo,  
zinë shpesh provoi  
po turpin jo!

Ja, afrohet Pasha  
me çallmën e përflakur,  
«Nuses» së parë  
t'i heqë duvakun.

Ngriu në vend Pasha,  
u zbeh si qiri.  
Në përralla ndodhin  
Të tilla mrekulli.



Treqind duvakët  
në tokë u flakën.  
Treqind trimat  
rrokën shpatat.

Menjëherë koka  
Pashës i fluturoi,  
buçiti Drini,  
dielli agoi.

Treqind trimat sulen  
porsi vetëtima,  
plot kokë turqish  
u mbush lugina.

Mbi pellgje gjaku  
yjet pikojnë,  
trimat dibranë  
bukur luftojnë.

Ulen qiejt, ulen  
të shohin kërdinë, —  
në fushë të betejës  
asgjë s'pipëtinë.

Vargmale kufomash  
kudo nëpër Tuç,  
Drini turbullohet  
nga përroi i kuq.

## NJË SHOQEJE

Fjalët e pëshpëritura vesh më vesh  
Na bijen mbi supe, na bijen mbi flokë.  
Duan t'na pengojnë të mos ecim bashkë,  
Duan t'na pengojnë të mos jemi shokë.

Nga gjithë vrimat e shpirtrave të kalbur  
Er' e thashethemeve le t'vërshtëllejë  
Mbi gërmadhat e fjalëve të tyre  
Miqësia e pastër do të shkëlqejë.



## KUR JU SHOH DUKE KËRCYER

Shqiptarë, kur ju shoh duke kërcyer  
Nëpër dasma e në festivale  
Më duket sikur nga sheshi i valles  
Merrni hov e ngjiti nëpër male.

Dhe që nga malet e thepisura  
Duke shkundur kostumet e bukura  
Më duket se të rreptë dhe krenarë  
Vetëtini shpatat nëpër luftëra.

Ju shkëlqejnë tirqit me gajtanë  
Ju valëvitet mëng' e bardhë, e madhe.  
Luftëtarë jeni ju, shqipëtarë  
Edhe në dasma e në festivale!



## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Pranvera .....	3
Fshatarët .....	4
Violina. ....	5
Kaloj rrëzë parcelës me grurë .....	6
Kur bie shi .....	7
Lulet e ëndërrave .....	8
Vjeshta. ....	10
Mbledhje e punëtorëve .....	12
Pendesa e Moisi Golemit .....	14
Nxënësit e shkollës së Natës .....	15
Xha Shemo .....	16
Sonte .....	17
Kur lexon lirikat e Serembes .....	18
Nuk kemi përse të kthehemi .....	19
Mimozat .....	20
Në sytë e Lidës .....	22
Dëborë. ....	23
Mari .....	25
Murro .....	27
Shqetësim .....	29
Pusaxhiu .....	31
Deti .....	35
Vogëlushja Vietnameze .....	36
Gjithmonë pranë .....	37
Tokat e reja .....	38
Flasin gjurmat .....	39

	Faqe
Intime .....	41
Për Gjokë Doçin .....	42
Gazi i zemrave .....	43
Sa bukur .....	44
Mirë se ardhe .....	45
Me kortarët .....	46
Arixheshka .....	48
Legjendë dibrane .....	49
Një shoqeje .....	61
Kur ju shoh duke kërcyer .....	62